

VENDIM
Nr.512, datë 2.12.1992

PËR NJË SHITESË SHPENZIMESH BUXHETORE PËR INSTITUTIN E SIGURIMEVE
SHOQËRORE

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personave që përfitojnë sipas neneve 1 dhe 6 të ligjit nr.7514, datë 30.9.1991 "Për pafajësinë, amnistinë, rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", u paguhet pension për kohë të kaluar, duke e llogaritur sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi për periudhën që u është mohuar kjo e drejtë.

2. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në buxhetin e vitit 1993, i parashikohen 80 milionë lekë për të mbuluar shpenzimet për pensionet sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi